



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2021:285913

Datë: 10.06.2024

Numri i dokumentit: 05800254

**C.nr.1876/2021**

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN** – Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Berat Spahiu, duke vendosur në procedurën kontestimore sipas padisë së paditësit Z.R nga Prishtina, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson av. Mustafë Musa nga Gjilani, kundër të paditurës Komuna e Gjilanit, me objekt kontesti kompensimi i dëmit, pas mbajtjes së seancës gjyqësore të datës 07.06.2024, mori këtë:

**AKTVENDIM**

I. Ndërpritet procedura kontestimore sipas padisë së paditësit Z.R nga Prishtina, kundër të paditurës Komuna e Gjilanit, për shkak të vdekjes së paditësit Z.R.

II. Procedura e ndërprerë do të vazhdojë kur trashëgimtarët e të ndjerit e marrin përsipër procedurën apo kur të njëjtit i thërret gjykata që ta bëjnë këtë me propozimin e palës kundërshtare.

**A r s y e t i m**

Paditësi Z.R, përmes përfaqësuesit të tij, ka ushtruar padi në këtë gjykatë ndaj të paditurës Komuna e Gjilanit, për kompensimin e dëmit.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të dt. 07.06.2024, përfaqësuesi i paditësit, av. Mustafë Musa, e ka njoftuar gjykatën se nga fqinji i paditësit, E.F, përmes telefonit, është njoftuar se paditësi Z.R ka ndërruar jetë.

Nga të lartcekurat e në mbështetje të nenit 277 pika a) të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ku shprehimisht është përcaktuar se *“Procesi gjyqësor ndërpritet kur pala ndërgjyqëse vdes ose humb zotësinë procedurale”*, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE GJILAN**  
**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL**  
**2021:285913, 10.06.2024**

Gjyqtari  
Berat Spahiu

**Udhëzim mbi mjetin juridik:** Kundër këtij aktvendimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh pas pranimit të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme dorëzohet përmes kësaj gjykate.